




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Shërbime Publike
Direkcija za Javne Službe
Department for Public Services

DATA:	20.02.2023
PËR/ZA/TO	Zyrën e Kryetarit të Komunës së Skenderaj
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtorit për Shërbime Publike, z. Alban Shala
NGA/OD/FROM;	Zyrtari për menaxhimin e mbeturinave, z. Gani Kerolli
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	RAPORT: Hartimi i draft rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Skenderaj

-Në bazë të vendimit më nr.02-352/03-0051103/22 të datës 12.10.2022 për caktimin e zyrtarit përgjegjës për përgatitjen (hartimin) e draft rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Skenderaj.

-Gjate punës për hartimin e draft rregullore për menaxhimin e mbeturinave në bashkëpunim me zyrën ligjore të komunës kemi marrë për bazë edhe kërkesën e kompanisë Uniteti njësi në Skenderaj për të adresuar të gjitha kërkesat dhe propozimet e tyre të nevojshme për draftim dhe implementim të kësaj rregulluare.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 15.7, nenit 34 (paragrafi 2 dhe paragrafi 7) dhe nenit 80 të Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina (Gazeta Zyrtare, nr.17, 29 qershor 2012) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare, nr. 29, 1 shtator 2022).

-Drafti i rregullores për menaxhimin e mbeturinave është hartuar duke konsultuar dhe me rregulloret e komunave të regjionit të Mitrovicës ku kemi marrë për bazë edhe koston e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave për kompaninë e menaxhimit të mbeturinave KRM "Uniteti" njësi në Skenderaj.

-Në mbledhjen komitetit për politikë dhe financa më datën 18.11.2022 kryetari i komunës propozon vendimin për dhënien në diskutim publike të draft rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

-Kuvendi i komunës së Skenderajt në mbledhjen e rregull të mbajtur më datën 29.11.2022 e miraton propozimin për dhënien në diskutim publike të draft rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Skenderajt.

-Draft-Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave ne komunën e Skenderajt ka qenë ne diskutim publik për 30 ditë duke filluar nga data; 02.12.2022 deri me datën 31.12.2022.

- Në diskutimin publik për Draft-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Skenderajt, që është mbajtur më datën 22.12.2022, në ora 10:00 në sallën e Kuvendit Komunal, kanë marrë pjesë 11 qytetarë (7 meshkuj dhe 4 femra). Prezantimi draft rregullores nga z. Gani Kerolli zyrtar për Menaxhimin e Mbeturinave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike në Komunën e Skenderajt, ka paraqitur para pjesëmarrësve përmbajtjen e draft-rregullores në fjalë dhe ndryshimet në nenet e caktuara.

Gjatë këtij diskutimi, nuk ka pas ndonjë kërkesë specifike në përmbajtjen e rregullores, me përjashtim të disa sqarimeve në nenet e caktuara, në të cilët zyrtari përgjegjës ka dhënë informatat e nevojshme plotësuese. Në Draft-Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Skenderajt qenë në diskutim publik që nga data 02 dhjetor 2022, e cila duke qenë në dispozicion të publikut, për komente, sugjerime, kërkesa apo vërejtje, në platformën shtetërore në adresën <https://konsultimet.rks-gov.net/>, si dhe në faqen e Komunës nuk është pranuar ndonjë kërkesë apo sugjerim nga ana e qytetarëve, brenda afatit sa ka qenë në proces të diskutimit publik.

-Pas përfundimi të afatit të diskutimit publik draft rregullorja për menaxhimin e mbeturinave është proceduar për miratim ne kuvendin komunal ne Skenderaj me datën 30.01.2023 ka nxjerre vendimin për miratimin e propozim vendimit më nr.02-352/11-0002083/23 të datës 10.01.2023.